

**Kontratë për Shërbimet e Parasë Elektronike**

Kjo kontratë për shërbimet e parasë elektronike "Kontrata" hyn në fuqi nga momenti kur klikoni butonin "Prano Termat dhe Kushtet". "Data e Hyrjes ne Fuqi", lidhet midis jush, (Përdoruesi/Klienti) dhe shoqërisë EasyPay Shpk, një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar me numër identifikimi K61730019P me adresë në: Rr" "Ismail Qemali", Objekti Nr.30 , Hyrja 7, Kati III, Tiranë, ("Shoqëria"/EasyPay):

**Neni 1****Terma e Përkufizime**

- 1.1 "Shërbimi EasyPay": për qëllim të kësaj Kontrate ka kuptimin e pagesës nga llogaria EasyPay, në emër dhe për llogari vetëm të Përdoruesit/Klientit, për çdo mall/shërbim që është listuar për shitje dhe për të cilin Përdoruesi/Klienti ka fonde të mjaftueshme për t'i paguar;
- 1.2 "Llogaria EasyPay": është llogaria e Përdoruesit/Klientit, e cila hapet menjëherë pas regjistrimit dhe kreditohet nga vetë klienti mbi bazën e blerjes së parasë elektronike. Kjo llogari nuk përbën depozitë bankare dhe Përdoruesi/Klienti nuk do të përfitojë interes nga këto fonde.
- 1.3 "Transaksioni i Pagesës": për qëllim të kësaj Kontrate ka kuptimin e veprimit financiar që konsiston në debitimin e llogarisë EasyPay (fondet) të blerësit dhe kreditimin e llogarisë të përfituesit (tregtarit) për vlerën e mallit/shërbimit;
- 1.4 "Para elektronike" janë instrumente të pagesave elektronike të emetuara nga EasyPay që i mundësojnë mbajtësit të tyre të kryejë pagesa elektronike.
- 1.5 "Blerja e Parasë Elektronike" është blerja nga Klienti me para 'cash' pranë një agjenti EasyPay, ose me pagesë nëpërmjet kartës së kreditit/debitit apo direkt nga llogaria bankare, në faqen e EasyPay, kundrejt shumave të barasvlershme, të Parasë Elektronike që kreditohet në llogarinë e Klientit.
- 1.6 "Agjent" është personi tregtar i kontraktuar nga EasyPay për të ofruar në emër dhe për llogari të EasyPay, Shërbimin EasyPay në Republikën e Shqipërisë.
- 1.7 "Pikë Shitje" është çdo dyqan, njësi tregtare e shitjeve me pakicë që drejtohet nga një Agjent.
- 1.8 "Debitim" është zvogëlimi i fondeve të llogarisë së Klientit si pasojë e një transaksioni të kryer nga ana e Klientit.
- 1.9 "Kreditimi" është çdo transaksion hyrës në llogarinë e Klientit dhe që kryhet me Para Elektronike, siç verifikohet nga EasyPay.
- 1.10 "Faqja e Internetit EasyPay" i referohet faqes së EasyPay në adresën e internetit [www.easypay.al](http://www.easypay.al).
- 1.11 "Monedha" është monedha shqiptare LEK, me të cilën operon EasyPay. Çdo monedhë tjetër konvertohet bazuar në kursin ditor të përditësuar nga Banka e Shqipërisë dhe llogariten nga platforma si vlera të barasvlershme në monedhën shqiptare LEK.
- 1.12 "Klienti" është subjekti nënshkruar/pranues i kësaj Kontrate në emrin e të cilit është regjistruar një llogari për Shërbimet EasyPay.
- 1.13 "Dërgues" është çdo klient i regjistruar, person juridik ose person fizik i cili në çastin e regjistrimit është mbi 18 vjeç, dhe që ka nënshkruar Kontratën për furnizimin e Shërbimit, i cili aktivizon llogarinë EasyPay e të marrë dhe të këmbëjë vlera monetare në para elektronike.
- 1.14 "Përfitues" është abonenti i çdo operatori të rrjetit të komunikimeve publike, i cili nuk është i regjistruar si Klient EasyPay, por që është në gjendje të marrë para elektronike të nisura nga Klienti EasyPay, dhe t'i këmbëjë ato me para në dorë 'cash', tek një nga pikat e shitjes.
- 1.15 "Kushtet e Përdorimit" janë ato të përcaktuara në Aneksin 1 të kësaj Kontratë siç mund të ndryshohen herë pas here.
- 1.16 "Kontrata" janë këto kushte të ofrimit të Shërbimit EasyPay së bashku me Formularin e Regjistrimit, Aneksin e Tarifave e aplikueshme, si dhe kushtet dhe afatet e tjera të njoftuara herë pas here sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të miratuara në zbatim të legjislacionit në fuqi, të cilat të gjitha së bashku janë pjesë e pandashme e Kontratës.
- 1.17 "Password" është fjalëkalimi që shërben për të verifikuar identitetin e përdoruesit EasyPay, pra kodi sekret që Klienti zgjedh për të aksesuar dhe përdorur llogarinë EasyPay.
- 1.18 "Shërbimi/et EasyPay" janë shërbimet që ofrohen, reklamohen, administrohen dhe zotërohen ekskluzivisht nga EasyPay për emetimin dhe tregtimin e Parave Elektronike ndërmjet Klientëve në bazë të Urdhrave të Transfertave

duke përfshirë regjistrimin e të gjithë Transaksioneve, verifikimin dhe konfirmimin të gjitha Transaksioneve të përfunduara dhe përditësimin e të dhënave të Llogarisë EasyPay së Klientit.

1.19 "Tarifat" janë tarifat dhe pagesat e tjera që bëhen sipas kësaj Kontrate për Shërbimet EasyPay.

1.20 "Të dhëna personale" janë çdo informacion në lidhje me një person fizik sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar përkatës.

1.21 "Urdhrat e Transferimit" janë urdhrat e dhëna me SMS ose kanal tjetër elektronik, online, për transferimin e Parave Elektronike nga një klient tek tjetri.

## **Neni 2**

### **Hapja e Llogarisë**

2.1 Çdo subjekt/individ që ka një Kartë SIM aktive të operatorëve të telefonisë celulare në Shqipëri dhe që ka akses në internet mund të regjistrohet për Shërbimin EasyPay.

2.2 Klienti EasyPay do të paguajë Tarifat e zbatueshme për përdorimin e Shërbimeve EasyPay dhe këto Tarifa mund të zbriten direkt nga Llogaria EasyPay përkatëse (ne ato raste ku shërbimi mund të mos jetë falas).

2.3 Klienti regjistrohet për përfitimin e Shërbimeve EasyPay te çdo Agjent EasyPay ose online në platformën web tek website EasyPay, e cila mund të aksesohet në pjesën më të madhe të shfletueseve të internetit, si dhe në aplikacionet që EasyPay disponon për telefonat "smart", të cilat mund të shkarkohen online për sistemet IOS, Android apo Windows Phone.

2.4 Përpara regjistrimit, Klienti duhet të japë të plota dhe të sakta informacionet e mëposhtme:

2.5 2.4.1 Klienti individ:

- Emër – Mbiemër - Atësia
- Numrin personal të identifikimit dhe një mjet identifikimi
- Adresën
- Datën e lindjes
- Numrin e celularit

2.4.2 Klienti person juridik:

- Emër
- Numrin NUIS
- Adresën
- Datën e regjistrimit
- Numrin e celularit

2.6 EasyPay ruan të drejtën që, në përputhje me rregulloret e brendshme të EasyPay, të refuzojë aplikimin e një subjekti që dëshiron të bëhet Klient EasyPay.

2.7 Me regjistrimin në Shërbimin EasyPay dhe aktivizimit të Llogarisë EasyPay nga agjenti EasyPay, shfletues interneti apo aplikacioni në telefonat inteligjentë, pasi të ketë zgjedhur një fjalëkalim, Klienti EasyPay do të ketë të drejtë të përdorë menjëherë Shërbimet EasyPay.

2.8 Klienti konsiderohet të ketë pranuar këtë Kontratë me nënshkrimin/pranimin e saj dhe të Formularit të Regjistrimit. Shërbimet EasyPay i vihen në dispozicion Klientit pas nënshkrimit të Kontratës.

2.9 EasyPay nuk garanton që Shërbimet EasyPay do të jenë të disponueshme në çdo kohë dhe nuk mban përgjegjësi dhe nuk do të jetë e detyruar të mbartë detyrime në lidhje me asnjë lloj dëmi të shkaktuar Klientit në rast mungese shërbimi nga ana e partnereve të EasyPay.

2.10 Në rast se fjalëkalimi për përdorimin e Shërbimeve EasyPay ka humbur apo i është zbuluar një pale të tretë, Klienti ka detyrimin të njoftojë menjëherë EasyPay në lidhje me humbjen apo zbulimin e fjalëkalimit dhe të kërkojë pezullimin e Shërbimit EasyPay. Klienti ka gjithashtu mundësi të kërkojë ndryshim fjalëkalimi, kërkesë e cila vjen vetëm në adresën e tij të e-mail. Në rast se klienti nuk zotëron më as adresën e email, ai mban vetë përgjegjësi dhe është i detyruar të kërkojë pezullim të menjëhershëm të llogarisë EasyPay dhe të kalojë për ndjekje të mëtejshme të rastit sipas procedurave të EasyPay.

2.11 Me nënshkrimin e Kontratës, Klienti pranon se për të mundësuar dhënien e përgjigjeve ndaj kërkesave të autoriteteve, EasyPay mund të kërkojë informacion personal apo dokumente të Klientit.

2.12 Klienti duhet të veprojë në përputhje me të gjitha udhëzimet që mund t'i jepen dhe/ose publikohen herë pas here për Shërbimet EasyPay.

**Neni 3****Mbyllja e Llogarisë dhe Ndërprerja e Shërbimeve**

3.1 Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe procedurën e EasyPay për pezullimin e Shërbimit EasyPay, pjesë e Udhëzimeve për Klientin, EasyPay mund të pezullojë, kufizojë ose përfundojë, tërësisht ose pjesërisht, ofrimin e Shërbimeve EasyPay dhe/ose të mbyllë Llogarinë e Klientit pa informuar atë dhe/ose pa asnjë detyrim çfarëdo qoftë (megjithëse EasyPay do të kryejë të gjitha veprimet e mundshme për të informuar Klientin që ky veprim është kryer ose do të kryhet) në rrethanat e mëposhtme:

- 3.1.1 nëse EasyPay merr dijeni apo ka arsye të besojë se pajisja celulare apo fjalëkalimi i Klientit për përdorimin e Shërbimeve EasyPay po përdoret ose është përdorur më parë në mënyrë të paautorizuar, të paligjshme, të papërshtatshme ose për veprimtari kriminale;
- 3.1.2 nëse Klienti nuk përmbush kërkesat e kësaj Kontrate në lidhje me Shërbimet EasyPay;
- 3.1.3 nëse Klienti njofton se pajisja celulare ka humbur apo është vjedhur apo fjalekalimi ka humbur;
- 3.1.4 për arsye që janë jashtë kontrollit të EasyPay, duke përfshirë por pa u kufizuar, ne forcën madhore, masa të organeve përkatëse rregullatorë apo ndryshime në legjislacion;
- 3.1.5 Kur EasyPay mbyll Llogarinë e Klientit bazuar në kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë.
- 3.2 Nëqoftëse llogaria e klientit qëndron jo-aktive për një periudhë 90 ditore, Llogaria e tij EasyPay do të pezullohet (bëhet “inaktive”) automatikisht nga EasyPay. Procesi pezullimit të Llogarisë do pasohet me njoftimin e klientit me sms dhe email.
- 3.3 Klienti mund të kërkojë ri-aktivizimin e llogarisë së tij përmes një telefonate tek numri i kontaktit të EasyPay brenda 60 ditëve nga dita e pezullimit të llogarisë. Nëse brenda këtyre 60 ditëve Klienti nuk kërkon ri-aktivizimin e llogarisë, llogaria e tij EasyPay mbyllet përfundimisht dhe klienti njoftohet përsëri me e-mail dhe sms. Në rast riaktivizimi, klientit i rikthehet gjendja pozitive e mbetur në llogarinë e tij sipas parashikimit në nenin vijues. Ky proces është automatik dhe do pasohet me njoftimin e klientit me sms dhe e-mail mbi arsyen e këtij pezullimi.
- 3.4 EasyPay do të mbyllë Llogarinë EasyPay të klientit brenda 3(tre) ditë pune me marrjen e kërkesës nga ana e Klientit për të mbyllur Llogarinë EasyPay.
- 3.5 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate dhe mbylljes së llogarisë EasyPay, instrumenti i parasë elektronike i mbetur gjendje në llogari do të shkatërrohet dhe Klienti ka të drejtën për të kërkuar shumën përkatëse në para të tepërcës, sipas parashikimeve të dhëna në Udhëzimet për Klientin (Aneksi 1) i kësaj Kontrate.
- 3.6 Klienti ka të drejtë të kërkojë pagimin e parasë elektronike në përputhje me procedurën e këmbimit të parave të zbatuara nga EasyPay në Udhëzimet për Klientin.
- 3.7 EasyPay nuk do të jetë përgjegjës kundrejt Klientit për dëme që shkaktohen nga një veprim apo mosveprim nga ana e EasyPay, nëse këto pasoja lindin për shkak të Kontratës apo parashikimeve ligjore, që kanë të bëjnë me të dhe vijnë si rezultat i mbylljes apo pezullimit të Llogarisë EasyPay të Klientit.

**Neni 4****Tarifat e Shërbimit**

- 4.1 Tarifat e përshkruara paguhen për çdo transaksion të kryer nga Llogaria EasyPay e Klientit. Lista e Tarifave ndryshohet vetëm me vendim të EasyPay dhe i njoftohet Klientit nëpërmjet publikimit në Faqen e Internetit të EasyPay dhe me mjetet e tjera të komunikimit të EasyPay. Njoftimi në lidhje me ndryshimet në fjalë do të bëhet sipas nenit 12 të kësaj Kontrate.
- 4.2 EasyPay do të mbajë nga Llogaria EasyPay e Klientit Tarifat e pagueshme për çdo Transaksion, pas përfundimit të Transaksionit. Klienti mund të shohë balancën e tij aktuale në cdo moment kur hyn në llogarinë e tij sipas të gjitha mënyrave që EasyPay ofron. Nëqoftëse klienti kërkon më shumë informacion ai mund të hyjë në platformën web, ku mund të shohë aktivitetin e tij të llogarisë për cdo periudhë të zgjedhur, madje mund ta ruajë atë edhe në formatin Microsoft Excel. Tek aktiviteti i llogarisë përfshihen të gjitha kreditimet që ai ka kryer si dhe debitimet si pasojë e aktivitetit të kryer në baze të pagesave/transfertave që ka përfituar nga EasyPay. Mbi Tarifat nuk aplikohet TVSH. Në rast ndryshimesh në legjislacion, nëse TVSH do të jetë e zbatueshme, vlera përkatëse do t'i shtohet tarifimit.
- 4.3 Të gjitha Tarifat e pagueshme nga Klienti në lidhje me përdorimin e Shërbimeve EasyPay dhe për të cilat Klienti do të konsiderohet se ka marrë dijeni, do të debitohen nga Llogaria EasyPay përkatëse pa njoftim të veçantë.

**Neni 5****Transaksionet**

- 5.1 Të gjitha Debitimet nga Llogaria e Klientit do të kryhen sipas Udhëzimeve të Transferimit të autorizuara me fjalëkalimin që Klienti ka zgjedhur gjatë regjistrimit ose përmes mënyrës që EasyPay mund t'i përshkruajë herë pas here. Përpara çdo Transaksioni për dërgim ose marrje të parasë fizike (Cash) që mund të kryhet, do të kërkohet të verifikohet identiteti i Klientit. Letërnjoftimi ose pasaporta e paraqitur do të regjistrohet nga Agjenti EasyPay për çdo Transaksion dërgim/marrje parash në dorë 'cash'.
- 5.2 Klienti nuk mund të kryejë Transaksione nga Llogaria EasyPay përkatëse, në rast se nuk ka mjaftueshëm Para Elektronike në Llogarinë EasyPay përkatëse, për të kryer Transaksionin dhe për të paguar Tarifat.
- 5.3 Cdo veprim përfundon kur klienti jep konfirmimin e tij për ekzekutimin e një trasaksioni. Në të gjitha rastet procesi i kryerjes së një trasaksioni shoqërohet me minimalisht 2 hapa konfirmimi nga klienti, deri në ekzekutimin final të pagesës/transfertës. Në shërbimet e pagesave klienti merr mandat fizik ose elektronik, në adresën e tij të email, ndërkohë që mund të marrë dhe konfirmimin me sms direkt nga ofruesi i shërbimit, ndërsa në rastin e transferimit të parasë elektronike, njoftohet me sms si marrësi ashtu dhe dërguesi. Transaksionet e regjistruara janë të identifikueshme online, në cdo moment për klientin e EasyPay dhe do të konsiderohen të rregullta derisa të vërtetohet e kundërta.
- 5.4 Me hapjen e Llogarisë EasyPay, Klienti do të jetë në gjendje të kryejë Transaksionet e mëposhtme:
- 5.4.1 Transaksion Krediti që konsiston në:
- Blerje të parasë elektronike me para në dorë 'cash', drejtpërdrejtë ndaj një Agjenti EasyPay në këmbim të një shume të barasvlershme që do të kreditohet në Llogarinë EasyPay të Klientit;
  - kreditim të llogarisë EasyPay të klientit nga llogaria bankare apo karta kreditit/debitit;
  - Transfertë nga një llogari tjetër klienti EasyPay në llogarinë EasyPay të klientit në fjalë.
- 5.4.2 Transaksion debitimi që do konsistojë në:
- pagesat e shërbimeve që ofrohen nga EasyPay;
  - transferta të parasë elektronike nga një llogari EasyPay në një llogari tjetër EasyPay;
  - Transferta të parasë elektronike nga llogaria e klientit EasyPay në llogarinë e tij në bankë apo në llogarinë e kartës së kreditit/debitit;
  - Tërheqje në para fizike cash të parasë elektronike të klientit nga llogaria e tij EasyPay, nëpërmjet agentëve të EasyPay.

Të gjithë këto transaksione janë lehtësisht të identifikueshme nga klienti në profilin e tij në sistemin EasyPay.

- 5.5 EasyPay nuk mund të kthejë/anullojë apo të ritarifojë Urdhrat e Pagesave/Transaksioneve përveç rasteve specifike kur Urdhërat e Transferimit përmbajnë gabime në lidhje me shumën e urdhëruar apo gabime në blerjen e mallit/shërbimit. Detajet për anulimin e pagesave/transfertave bëhen me kërkesë me shkrim nga klienti ndaj EasyPay sipas udhëzimeve në Udhëzimet për Klientin.

**Neni 6****Kushtet për Sigurinë**

- 6.1 Vetëm një fjalëkalim mund të lidhet me Llogarinë EasyPay të Klientit në çdo kohë dhe vetëm Klienti mund të përdorë llogarinë EasyPay me emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin përkatës.
- 6.2 Klienti ka përgjegjësi ruajtjen dhe përdorimin e përshtatshëm të llogarisë së tij, pavarësisht kanalit që ai zgjedh për përdorimin e platformës EasyPay (web/mobile application), për ruajtjen dhe mbajtjen e kredencialeve dhe për të gjithë Transaksionet që do të kryhen në Llogarinë EasyPay, duke përdorur kredencialet e tij. Klienti është përgjegjës për kryerjen e të gjitha Transaksioneve në llogarinë e tij, në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.
- 6.3 Klienti EasyPay ka detyrimin të njoftojë menjëherë EasyPay në lidhje me ndryshimin e të dhënave personale.

6.4 Klienti duhet të njoftojë menjëherë Shërbimin ndaj Klientit dhe do t'i japë atyre të gjithë të dhënat e kërkuara që kanë të bëjnë me verifikimin e klientit, bazuar në procedurën "Njih Klientin Tënd" në rast se ka ndodhur një nga ngjarjet si më poshtë:

6.4.1 Vihet re se ka ndodhur një abuzim apo veprimtari mashtrimi në lidhje me kredencialet e tij përdorues+fjalëkalim dhe se përmes këtij veprimi palë të treta kanë marrë akses në Llogarinë EasyPay;

6.4.2 Janë kryer Transaksione pa miratimin paraprak të Klientit;

6.4.3 Vihet re një gabim apo mospërputhje në balancën e Llogarisë EasyPay të Klientit.

6.4.4 Llogaria e Klientit është shkatërruar, keqpërdorur, humbur, falsifikuar/ kopjuar.

## **Neni 7**

### **Përdorimi i të Dhënave Personale dhe e Drejta e Autorit**

7.1 EasyPay siguron ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale të Klientit dhe Transaksioneve të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parashikimet e kësaj Kontrate. Në veçanti, EasyPay merr përsipër të respektojë fshehtësinë e Klientëve EasyPay dhe t'i trajtojë të dhënat personale të klientëve me përkujdesjen e duhur, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe qëllimet e lejuara të veprimtarisë tregtare.

7.2 Me nënshkrimin e Kontratës, Klienti njih dhe pranon se EasyPay apo Agjentët EasyPay mund të kontaktojnë herë pas here me Klientin përmes postës, telefonit, postës elektronike ose SMS për të rejtat në lidhje me shërbimin e ofruar dhe të pranuar nga Klienti. Nëse Klienti EasyPay vendos që të mos marrë komunikime të këtij lloji, ai/ajo mund ta kërkojë këtë në çdo kohë, duke kontaktuar Shërbimin ndaj Klientit të EasyPay.

7.3 Të gjitha të drejtat e autorit (copyright), markat tregtare dhe të drejta të tjera të pronësisë intelektuale të përdorura gjatë dhënies së Shërbimeve EasyPay janë të regjistruara në pronësi të EasyPay dhe Klienti nuk mund përfitojë të drejta mbi to.

## **Neni 8**

### **Përgjegjësitë e Klientit**

8.1 Klienti përgjigjet për të gjitha Tarifatat e zbatueshme për Transaksionet e kryera.

8.2 Klienti është i vetmi person përgjegjës për informacionin dhe komunikimet e transmetuara.

8.3 Klienti nuk duhet t'i përdorë Shërbimet EasyPay për kryerjen e veprimeve në shkelje të legjislacionit shqiptar.

## **Neni 9**

### **Ndryshimi i Kushteve dhe Tarifave**

9.1 EasyPay ka të drejtën të ndryshojë në çdo kohë kushtet e kësaj Kontrate dhe Tarifatat. Këto ndryshime do t'i njoftohen Klientit 10 (dhjetë) dite në advance, me anë të një SMS-je tek numri i telefonit apo e-mail të Klientit i lidhur me Shërbimin EasyPay, ose nëpërmjet Faqes së Internetit të EasyPay dhe duke përdorur çdo mjet të përshtatshëm publik. Me kalimin e afatit 10 (dhjetë) ditë, Klienti do të konsiderohet se është njoftuar për këto ndryshime.

9.2 Me vazhdimin e përdorimit të Shërbimeve EasyPay, pas hyrjes në fuqi të Kushteve dhe Tarifave të ndryshuara të përdorimit, Klienti do të konsiderohet se ka rënë dakord për ndryshimet e parashikuara më sipër. Nëse Klienti nuk është dakord me një nga ndryshimet, atëherë ai/ajo nuk duhet të vazhdojë të kryejë Transaksione dhe duhet të paraqitet në njërin prej Agjentëve EasyPay ose të kontaktojë Shërbimin ndaj Klientit për të kërkuar zgjidhjen e Kontratës EasyPay brenda afatit 10 (dhjetë) ditë të njoftimit, përndryshe do të konsiderohet se i ka pranuar këto ndryshime.

## **Neni 10**

### **Kufizimi i Përgjegjësisë**

10.1 Të gjithë Agjentët EasyPay përfaqësojnë Pika Shitje të autorizuar dhe të pavarura nga EasyPay.

10.2 EasyPay nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjet që Klienti mund të pësojë gjatë përdorimit të EasyPay, përveç rasteve nëse këto janë shkaktuar kur:



- 10.2.1 Transaksioni nuk është ekzekutuar ose është ekzekutuar gabim;
- 10.2.2 Transaksioni nuk është autorizuar nga Klienti, si dhe për gabime apo pasaktësi të shkaktuara nga EasyPay, në lidhje me mbajtjen e Llogarisë EasyPay të Klientit.
- 10.3 Mbulimi i detyrimeve financiare sipas parashikimeve më sipër, përfshin vetëm:
  - 10.3.1 vlerën e transaksionit të paekzekutuar ose të ekzekutuar gabim;
  - 10.3.2 shumën e nevojshme për të rikthyer tepriçën e Llogarisë EasyPay të Klientit në gjendjen e mëparshme, përpara kryerjes së Transaksionit të paautorizuar.
- 10.4 EasyPay nuk është përgjegjëse për humbje që lindin për shkak të mosfunksionimit, keqfunksionimit apo vonesave në rrjetet e komunikimeve elektronike, pajisjeve celulare apo pajisjeve të tjera fundore, që rezultojnë nga rrethana përtej kontrollit të arsyeshëm.

## **Neni 11**

### **Gjendja e Llogarisë**

- 11.1 Klienti mund të marrë në cdo moment një raport të balancës së llogarisë së tij, në cdo kanal që ai zgjedh të aksesojë (web/aplikacion mobile), ndërkohë që nga web ai mund të shohë të detajuara të gjithë veprimet e kryera, aktivitetin e llogarisë, për cdo periudhë që ai zgjedh, madje ai mund ta ekspotojë raportin e shfaqur dhe në formatin Excel,
- 11.2 Me kërkesën e Klientit, mund të vihen në dispozicion të Klientit gjendja e Llogarisë EasyPay. Proçedurat për këtë shërbim janë përcaktuar në Udhëzime për Klientin.

## **Neni 12**

### **Njoftimet**

- 12.1 EasyPay ka të drejtë t'i dërgojë Klientit informacion dhe njoftime në lidhje me këtë Kontratë dhe Shërbimin EasyPay të ofruara nga EasyPay dhe të pranuar nga Klienti, përmes SMS-ve si dhe mjeteve të tjera të komunikimit dhe në adresat që Klienti ka vënë në dispozicion në Formularin e Regjistrimit.
- 12.2 Klienti pranon se do të njoftohet me SMS për të rejtat mbi EasyPay, mbi llogarinë e tij dhe oferta të ndryshme.
- 12.3 Njoftimet nga Klienti EasyPay duhet të dërgohen në adresën: Rruga: "Ibrahim Rugova", kompleksi "Green Park", kulla 1, Tiranë, ose duke kontaktuar Shërbimin ndaj Klientit në numrin [042264982], ose sipas ndryshimeve që mund të bëhen të ditura herë pas here.

## **Neni 13**

### **Juridiksioni dhe Ligji i Zbatueshëm**

- 13.1 Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Mosmarrëveshjet e mundshme që mund të lindin midis palëve gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate do të zgjidhen nga Gjykata e Tiranës.

## **Neni 14**

### **Afati dhe Përfundimi i Kontratës**

- 14.1 Kjo Kontratë lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e nënshkrimit të Kontrates me Klientin, e cila nënshkruhet së bashku dhe në të njëjtën kohë me Formularin e Regjistrimit.
- 14.2 Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të Kontrates në përputhje me parashikimet e saj, duke i dhënë palës tjetër njoftim me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.
- 14.3 Në rast se EasyPay do të ofrojë shërbime të tjera për Klientin apo do të aplikojë oferta të tjera specifike, të cilat do të jenë të kufizuara në kohë për konsum, kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate do të zbatohen në masën që nuk përbejnë shkelje të kushteve dhe afateve specifike të marrëdhënieve në lidhje me ofertën përkatëse.

## **Neni 15**

**Të Ndryshme**

- 15.1 Kjo Kontratë, siç do të mund të ndryshohet herë pas here, përbën marrëveshjen e plotë e të detyrueshme nga ana ligjore, për Palët.
- 15.2 Kjo Kontratë nuk mund t'i kalohet apo transferohet asnjë personi tjetër.
- 15.3 Mospërmbushja e detyrimeve të kësaj Kontrate apo vonesa e shkaktuar nga Palët në ushtrimin e të drejtave apo detyrimeve sipas kësaj Kontrate, nuk do të interpretohet si heqje dorë prej tyre dhe ushtrimi vetëm i një të drejte apo detyrimi, apo ushtrimi i pjesshëm i të drejtave dhe detyrimeve, nuk do të pengojë ushtrimin e mëvonshëm apo të ndryshëm të tyre apo ushtrimin e një të drejte apo detyrimi.
- 15.4 Nëse një dispozitë në këtë Kontrate deklarohet si e pavlefshme apo e pazbatueshme nga një gjykatë apo organ administrativ kompetent, pavlefshmëria dhe pazbatueshmëria e këtij parashikimi nuk do të prekë vlefshmërinë dhe/ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Kontrate.
- 15.5 Në Faqen zyrtare të EasyPay, dhe Udhëzimet për Klientin gjenden udhëzime për përdorimin e Shërbimeve EasyPay dhe kryerjen e Transaksioneve, pajisjet ku mund të kryhen Shërbimet EasyPay, shërbimet dhe transaksionet që ofrohen nga EasyPay dhe mund të kryhen përmes EasyPay;
- 15.6 Tarifat e përdorimit dhe Kufijtë minimalë dhe maksimalë të Transaksioneve të lejuara gjenden në Aneksin 1 (Kushtet dhe Afatet e ofrimit të Shërbimit EasyPay).
- 15.7 EasyPay nuk mban përgjegjësi ndaj Klientëve për dëmet indirekte që mund të vijnë si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të palëve të treta të lidhura me EasyPay për arsye të parashikimeve kontraktore apo ligjore.
- 15.8 Kjo Kontratë dhe anekset e saj përpilohen në 2 (dy) ekzemplarë, të cilat kanë të njëjtën përmbajtje në gjuhën Shqipe, nga të cilat 1 (një) kopje mbahet nga EasyPay dhe 1 (një) mbahet nga Klienti EasyPay. Të dy ekzemplarët nënshkruhen nga palët.

Klienti EasyPay: Jam njohur dhe kam pranuar plotësisht Termat dhe Kushtet e kësaj Kontrate.

**EasyPay SHPK**

Nënshkrimi-vula

**Klienti**

Nënshkrimi-vula

(emri/mbiemri i personit të autorizuar)

(emri/mbiemri)

Data \_\_\_\_\_

**Aneks 1 – Kushtet dhe Afatet e ofrimit të Shërbimit EasyPay****1. Udhëzime mbi procedurën e paraqitjes së ankesave dhe zgjidhja e tyre**

Klientët EasyPay mund të paraqesin ankesë për çështje të ndryshme të lidhura me shërbimet EasyPay. Mënyrat për paraqitjen e kërkesave janë si më poshtë:

- Nëpërmjet telefonatave në numrin e shërbimit për klientët EasyPay – 04 2264982. Shërbimi është i disponueshëm nga e hëna në të shtunë nga ora 09:00 – 21:00.
- Pikat e Shitjeve EasyPay gjatë orëve të punës së këtyre pikave.
- Postë elektronike duke dërguar ankesën në adresën e e-mail-it: info@easypay.al
- Ankesë me shkrim të dërguar në adresën zyrtare EasyPay SH.P.K., Rruga: Ismail Qemali, Objekti Nr 10, Hyrja 7 , Kati 3, Tiranë.

Afati kohor për njoftimin e Klientit në lidhje me përfundimet e analizës së ankesës është deri 3 (tre) ditë pas marrjes së saj.

**2. Udhëzime në lidhje me trajtimin e kërkesave për Transaksionet e kryera dhe për gjendjen e Llogarisë EasyPay.**

Klientët e regjistruar në EasyPay mund të informohen për gjendjen e Llogarisë së tyre në këto mënyra:

- Nga celulari i tyre/web: Të gjithë Klientët EasyPay mund të kontrollojnë gjendjen e Llogarisë së tyre si dhe transaksionet e kryera nga telefoni i tyre/kompjuteri përmes të cilit marrin Shërbimet EasyPay.
- Duke telefonuar Shërbimin e Klientit EasyPay në numrin 04 2264982 për të kërkuar informacion mbi gjendjen e Llogarisë së tij. Në këtë rast për të verifikuar identitetin e tij si mbajtës i Llogarisë, Klienti duhet t'i përgjigjet saktë pyetjeve të EasyPay për vërtetimin e të dhënave personale të identitetit.

**3. Limit i Transaksioneve**

- Në bazë të politikave të sigurisë dhe rregullores së Bankës së Shqipërisë, për klientët është vendosur një limit transaksionesh vjetore sipas Tabeles se Limiteve ne Aneksin 2.
- Klienti mund të kreditohet llogarinë e tij EasyPay pa asnjë komision, nëpërmjet kartës së tij Visa ose MasterCard/Maestro apo nëpërmjet e-banking.
- Në bazë të politikave të sigurisë së EasyPay dhe të bankës partnere, klientët e EasyPay që përdorin shërbimin Eccobet/LottoSport/EuroLoto nuk duhet të përdorin MasterCard/Maestro për të rimbushur llogarinë e tyre .

**4. Mbyllja e Llogarisë EasyPay**

Zgjidhja e marrëveshjes me shoqërinë EasyPay Sh.P.K. dhe mbyllja e llogarisë EasyPay mund të kryhet sipas rasteve të mëposhtme:

- Me kërkesë të klientit

Klienti mund të kërkojë me shkrim 30 ditë përpara zgjidhjen e kontratës me shoqërinë EasyPay Sh.P.K. dhe mbylljen e Llogarisë përkatëse EasyPay.

Në rast se Klienti ka gjendje në llogarinë e tij, duhet të tërheqi vlerën gjendje përpara ndërprerjes së marrëveshjes.

- Për shkaqe të tjera

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të paligjshme nga klienti, EasyPay Sh.P.K. kryesisht apo me kërkesë të organeve shtetërore të autorizuara, mund të pezullojë dhe/ose mbyllë përfundimisht llogarinë EasyPay, dhe/ose bllokojë/anullojë fondet në gjendje.

Për tërheqjen e fondeve (nëse ka gjendje) të një llogarie të mbyllur ndiqen hapat si më poshtë:



Klienti paraqet me shkrim kërkesën për tërheqjen e fondeve duke kontaktuar EasyPay Sh.P.K. Pas miratimit të kërkesës dhe brenda 7 (shtatë) ditëve pune, klientit i bëhet transferimi i parave në një numër që ai ka specifikuar në kërkesën e dorëzuar. Klienti mund t'i tërheqë paratë e transferuara në një prej pikave të autorizuara EasyPay Sh.P.K.

#### **5. Udhëzime për procedurën e anulimit të Transaksioneve EasyPay**

Klienti mund të kërkojë menjëherë anulimin e një transaksioni të kryer nga llogaria e tij në numrin e shërbimit për klientët EasyPay – 04 2264982.

Pas verifikimit të transaksionit, EasyPay ruan të drejtën të anulojë ose jo këtë veprim.

#### **Aneks 2 – Nivele dhe Limite për Klientët**

1) Përshkrimi i Niveleve

##### **Niveli 1**

Çdo klient që regjistrohet në EasyPay duke plotësuar saktë të gjitha të dhënat, është në nivelin 1. Në këtë nivel klienti mund të kryejë transaksione brenda vlerave të përcaktuara në tabelën e limiteve. Klienti mund të blejë një apo disa shërbime/produkte pa patur kufizime në numër, por pa kaluar vlerën e përcaktuar në tabelë. Periudha minimale që klienti mund të qëndrojë në nivelin 1 është 7 (shtatë) ditë nga data e regjistrimit.

##### **Niveli 2**

Klienti kalon në nivelin 2 vetëm nëse ka plotësuar kushtet e kalimit të nivelit. Në të kundërt klienti do të vazhdojë të mbetet në nivelin 1 për një periudhë të pacaktuar. Në nivelin 2 kalojnë automatikisht të gjithë ata klientë të cilët në një periudhë minimale 30 (tridhjetë) ditë nga data e regjistrimit kanë kryer të paktën 3 transaksione të suksesshme pagesash të 2 shërbimeve/produkteve të ndryshme (pa përfshirë shërbimin Eccobet/LottoSport/Eurolloto).

##### **Niveli 3**

Në nivelin 3 kalon automatikisht një klient i nivelit 2 vetëm në rast se:

- Për një periudhë minimale 3 (tre) muaj nga data e regjistrimit, ka kryer pagesa për shërbime/produkte të ndryshme (pa përfshirë shërbimin Eccobet/LottoSport/Eurolloto), **dhe** kreditimet e llogarisë EasyPay i ka kryer me të njëjtën kartë bankare, ose maksimumi dy karta krediti/debiti të ndryshme. Minimumi i rimbushjeve të llogarisë me këto dy karta duhet të jetë 10 (dhjetë).
- Për 1 vit kalendarik (365 ditë) ka kryer në total pagesa për shërbime/produkte (pa përfshirë shërbimin Eccobet/LottoSport/Eurolloto) në vlerën **100 000 lekë**.

**2) Tabela e Limiteve**

Përshkrimi	(1) Vlera Maksimale Ditore e Mbushjeve të Llogarisë që mund të kryejë një Klient	(2) Vlera Maksimale për një Transfertë	(3) Vlera Maksimale Vjetore e Mbushjeve të Llogarisë që mund të kryejë një Klient	(4) Vlera Maksimale Ditore e të gjitha veprimeve për të gjitha shërbimet që mund të kryejë një Klient	(5) Vlera Maksimale e Balancës	(6) Vlera Maksimale Ditore e Rimbushjeve Eccobet/Lottosport/Euroлото që mund të kryejë një Klient
<b>Niveli 1</b>	35,000.00	10,000.00	150,000.00	35,000.00	35,000.00	5,000.00
<b>Niveli 2</b>	150,000.00	20,000.00	400,000.00	150,000.00	150,000.00	20,000.00
<b>Niveli 3</b>	200,000.00	35,000.00	700,000.00	250,000.00	250,000.00	30,000.00

Përshkrimi	(7) Vlera Maksimale e të gjitha veprimeve për të gjitha shërbimet që mund të kryejë një klient në javën e parë të regjistrimit	(8) Vlera Maksimale për një Mbushje Llogarie EasyPay	(9) Vlera maksimale vjetore e të gjitha veprimeve për të gjitha shërbimet që mund të kryejë një klient	(10) Vlera minimale për një rimbushje llogarie	(11) Vlera Minimale e Balancës	(12) Vlera Maksimale për Transfertë te Klientët e Paregjistruar
<b>Niveli 1</b>	50,000.00	35,000.00	150,000.00	100.00	0.00	0.00
<b>Niveli 2</b>	N/A	40,000.00	400,000.00	100.00	0.00	10,000.00
<b>Niveli 3</b>	N/A	50,000.00	700,000.00	100.00	0.00	35,000.00

*\* Të gjitha vlerat e mësipërme janë të shprehura në Lekë dhe në përputhje me rregulloret në fuqi.*

*Shënim: Tek pika (7) e tabelës nuk ka vlera për nivelin 2 dhe 3, sepse çdo klient në javën e parë të regjistrimit ndodhet në nivelin 1.*

EasyPay SHPK  
Nënshkrimi-vula

Klienti  
Nënshkrimi-vula

Data \_\_\_\_\_